

MANUAL PËR PARALIGJORËT NË SHQIPËRI



“Manual për Paraligjorët në Shqipëri” është përgatitur në kuadër të projektit “Enhancing access to justice through paralegals”, i cili është pjesë e Projektit “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”, që zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Shkurtime

OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
BE	Bashkimi Evropian
Ligji nr.111/2017	Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
Manual	Manuali për Paraligjorët në Shqipëri
CLE	Centre for Legal Empowerment
Kërkuesi	Personi i interesuar

Përmbajtja

Shkurtime	3
I. Hyrje.....	5
II. Ndhma juridike e garantuar nga shteti	6
III. Profesioni i paraligjorit	11
IV. Puna e paraligjorit	14
V. Paraligjori së shpejti një profesion i rregulluar	20
LEGJISLACIONI.....	21
ANEKSI NR.1	22
FORMULARËT E APLIKIMIT	22
ANEKSI NR.2	29
TARIFAT PËR AVOKATËT	29

I. Hyrje

Aksesi në sistemin e drejtësisë është një parim themelor i shtetit të së drejtës dhe demokracisë në një vend. Në mungesë të garantimit të tij, qytetarët nuk janë në gjendje të përcjellin zërin e tyre, të ushtrojnë të drejtat, të konstatojnë diskriminimin, të ndalojnë shkeljen e së drejtës dhe të sjellin ndryshimin në shoqëri jo vetëm për ta, por dhe për gjithë të tjerët. Ky si koncept përfshin të gjithë elementët e nevojshëm për t'u mundësuar individëve të identifikojnë dhe përmbushin nevojat e tyre të përditshme ligjore, të adresojnë problemet e tyre ligjore, të kërkojnë zgjidhje për ankesat dhe të kërkojnë që të drejtat e tyre të respektohen¹.

Ndihma juridike është garancia themelore që i garantohet të gjithë qytetarëve shqiptarë, duke përfshirë këtu dhe grupet vulnerabël, të cilët e kanë më të vështirë aksesin në shërbimet shtetërore dhe në sistemin e drejtësisë. Nëpërmjet saj qytetarët mund t'i drejtohen gjykatës, prokurorisë, institucioneve të administratës publike, të përjashtohen nga tarifat apo nga të gjitha shpenzimet e procesit gjyqësor dhe të kenë mundësi të përfitojnë shërbime jo-diskriminuese, dhe gjithëpërfshirëse të cilat promovojnë aksesin në drejtësi, si dhe orientojnë vendimmarrjen shtetërore drejt qytetarëve.

Miratimi i legjislacionit për ndihmën juridike të garantuar nga shteti bëri të mundur krijimin e një e sistemit institucional shtetëror dhe jo vetëm, për garantimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike për secilën formë të ndihmës juridike, duke përfshirë këtu ndihmën juridike parësore, dytësore, përjashtimin nga të gjitha shpenzimet e procesit gjyqësor deri në ekzekutimin e vendimit.

Që prej vitit 2018, me fillimin e zbatimit të legjislacionit të miratuar në kuadër të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, rrjeti i aktorëve të përfshirë në këtë proces ka qenë gjithmonë në rritje. Gjithashtu dhe kërkesat e qytetarëve për të përfituar nga shërbimi i ndihmës juridike kanë ardhur duke u rritur dhe në kuadër të rritjes së tyre janë shfaqur profesione të reja, të cilat ndihmojnë komunitetin të orientohe dhe ndjekin zgjidhjen e problematikave të konstatuara. Paraligjori është një ndër profesionet e parregulluara ende nga legjislacioni shqiptar dhe që po fillon të luaj një rol të rëndësishëm në kuadër të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Projekti “Enhancing access to justice through paralegals”, i cili është pjesë e Projektit “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”, që zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC) ka në fokus të tij fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve të paraligjorëve. Në kuadër të arritjes së këtij objekti, është hartuar “Manuali për Paraligjorët në Shqipëri” (Manual), i cili synon të informojë paraligjorët dhe të rris kapacitetet e tyre në kuadër të përfitimit dhe ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

¹ A2JBC Working Group, School of Criminology, University of the Fraser Valley, & International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy: Access to Justice Measurement Framework, faqe 1.

Manuali do të jetë një udhërrëfyes për të gjithë paraligjorët në punën e tyre të përditshme në kontakt me komunitetin, duke parashtruar në mënyrë të detajuar informacionin mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti, llojet e saj, institucionet shtetërore përgjegjëse, ofruesit e ndihmës juridike, procedurat e ndjekur për të përfituar prej saj, dokumentacionin e nevojshëm, legjislacionin në fuqi etj.

Manuali i vjen në ndihmë të gjithë atyre që mendojnë se mund të ushtrojnë profesionin e paraligjorit në të ardhmen duke parashtruar: detyrat që ai do të realizojë, njohuritë dhe aftësitë që duhet të zotërojë, ndryshimi i profesionit të paraligjorit me profesionet e tjera. Duke mbajtur në konsideratë faktin se legjislacioni në fuqi nuk e njeh ende profesionin e paraligjorit, ky Manual kërkon të nxis njohjen e profesionit nga legjislacioni në fuqi, duke parashtruar dhe rrugën ligjore që duhet të ndiqet për të arritur në njohjen e këtij profesioni.

Nëpërmjet këtij Manuali, paraligjorët paraqiten tek komuniteti më të përgatitur dhe janë në gjendje që të ofrojnë zgjidhjet e duhura për problematikat e konstatuara, duke rritur kështu numrin e qytetarëve që përfitojnë nga sistemi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

II. Ndihma juridike e garantuar nga shteti

Ndihma juridike e garantuar nga shteti është një mekanizëm i rëndësishëm për garantimin e aksesit të grupeve vulnerabël në sistemin e drejtësisë. Rëndësia e ndihmës juridike parashtrohet dhe nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) nëpërmjet dy akteve të rëndësishme:

- ✚ Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së për Qasjen në Ndihmën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale 2012²;
- ✚ Konventa Ndërkombëtare e OKB-së mbi të Drejtat Civile dhe Politike³, e cila përcakton se: “*Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht të barabartë të ketë këto garanci minimale: Të jetë i pranishëm gjatë procesit dhe të mbrohet vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij; në qoftë se nuk ka mbrojtje, duhet të informohet për të drejtën e tij që të ketë një të tillë dhe, kurdoherë që e kërkon interesi i drejtësisë, atij duhet t’i caktohet një mbrojtje falas në cilindo rast të tillë nëse ai nuk ka mjete për të paguar.*”; dhe
- ✚ Konventa e Gjenevës e vitit 1951 në lidhje me Statusin e Refugjatëve⁴, e cila përcakton se: “*1. Një refugjat do të ketë qasje lirisht në gjykatat sipas së drejtës së territorit të të gjitha Shteteve Kontraktuese. 2. Një refugjat gëzon në Shtetin Kontraktues në të cilin ai ka vendbanimin e tij të zakonshëm, të njëjtin trajtim si një shtetas i po këtij shteti, në çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në Gjykata, duke përfshirë ndihmën juridike dhe përjashtimin*

² UN Doc. A / C.3 / 67 / L.6, at.

³ Neni 14, pika 3, shkronja “d”.

⁴ Neni 10, shkronja “ç”.

nga cautio judicatum solvi. 3. Një refugjati do t'i jepet për çështjet e përmendura në paragrafin 2, në vende të ndryshme nga ai në të cilin ai ka vendbanimin e tij të zakonshëm, trajtimi që i është dhënë një shtetasi të vendit të vendbanimit të tij të zakonshëm.”.

Të njëjtën rëndësi i jep dhe e drejta e Bashkimit Evropian (BE) ndihmës juridike, ku në Nenin 47 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE përcakton se:

“Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara nga e drejta e Bashkimit, ka të drejtën të paraqesë një mjet ligjor efektiv në një gjykatë sipas kushteve të parashikuara në këtë nen. Personat të cilët nuk kanë mjete të mjaftueshme, u jepet ndihmë juridike, në masën që kjo ndihmë është e nevojshme për të garantuar në mënyrë të efektshme aksesin në gjykatë.”

Në të njëjtën linjë është dhe Këshilli i Evropës ku në nenet 6, 96 të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut dhe në Rezolutën për Ndihmën Juridike dhe Këshillimin parashtron rëndësinë e garantimit të ndihmës juridike për grupet vulnerabël.

Angazhimi i Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare dhe në procesin e integritimit evropian, nxiti ndryshime të shumta në legjislacionin shqiptar dhe në vitin 2017, Shqipëria miratoi ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” (Ligji nr.111/2017) dhe aktet nënligjore të nevojshme për zbatimin e tij. Ky ligj ka për qëllim:

- krijimin e një sistemi për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë;
- sigurimin e mirëorganizimit, mirëadministrimit dhe mirëfunksionimit e institucioneve shtetërore përgjegjëse për administrimin e ndihmës juridike;
- sigurimin e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike në mënyrë profesionale, cilësore, eficiente dhe efektive.

Ligji nr.111/2017 përcakton se ndihma juridike është shërbimi juridik falas dhe shërbime të tjera, që i garantohen dhe financohen nga shteti, personave që përmbushin kriteret ligjore. Ndihma juridike ndahet në:


- Ndihmë juridike parësore: është ai lloj shërbimi ligjor i cili ofrohet për mosmarrëveshjet që mund të zgjidhen pa qenë e nevojshme t'i drejtohesh Gjykatës. Kjo kategori shërbimi ofrohet nga punonjësit me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës ligjore, organizatat jofitimprurëse të autorizuara si dhe prej Klinikave të Ligjit pranë Universiteteve. Detyrat e ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore konsistojnë në:
 - ✓ Informimin e qytetarëve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
 - ✓ Dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e formularëve për përfitimin e këtij shërbimi dhe në plotësimin e dokumentave që nevojiten;

- ✓ Përpilimi i dokumentave të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore,
- ✓ Orientojnë dhe këshillojnë shtetasit mbi mënyrën se si ata duhet të veprojnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tyre, dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- Ndihmë juridike dytësore është ai lloj shërbimi ligjor që ofrohet për problematikat, zgjidhje e të cilave mund të realizohet vetëm nëpërmjet gjykatës apo prokurorisë. Kjo lloj ndihme ofrohet nga avokatët e licencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Personi, me anë të avokatit falas i drejtohet gjykatës ose prokurorisë për zgjidhjen e çështjeve apo problematikave të çdo fushe. Kjo lloj ndihme përfshin shërbimin juridik, që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjisllacionit procedural penal.
- Përrjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore është një formë e ndihmës juridike për përrjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, me vendim të gjykatës kompetente, nëse plotësohen kriteret ligjore. Ajo përrfshihen përrjashtimin nga:
 - ✓ tarifa gjyqësore është tarifa, sipas kuptimit të dhënë nga legjisllacioni në fuqi për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
 - ✓ shpenzimet gjyqësore janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor, të nevojshme për gjykimin, sipas kuptimit të dhënë në legjisllacionin procedural; përveç tarifës gjyqësore;
 - ✓ tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit është tarifa që i parapaguhet shërbimit përrmbarimor gjyqësor shtetëror, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv, sipas parashikimeve të legjisllacionit në fuqi.

Garantimi dhe ofrimi i ndihmës juridike kërkon angazhimin e institucioneve shtetërore dhe jo vetëm:



Në bazë të llojit të ndihmës juridike të ofruar institucionet shtetërore dhe jo vetëm, ndërveprojnë sipas skemës së mëposhtme, për të garantuar aksesin për të gjithë personat që plotësojnë kriteret ligjore për të përfituar prej saj:



III. Profesioni i paraligjorit

Në institucionet shtetërore dhe jo vetëm, paraligjori nuk njihet si një profesion i rregulluar me ligj në kuadër të garantimit dhe ofrimit të ndihmës juridike, por që vitet e fundit roli i tij në Shqipëri është rritur. Nëse do të kërkonim në ligjin nr.111/2017 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij për një përkufizim mbi konceptin paraligjor, nuk do të arrinim të gjenim një përkufizim të tij. Në këtë kapitull, për t'i ardhur në ndihmë të gjithë atyre që synojnë ta ushtrojnë këtë profesion, do të parashtrijmë:

- detyrat që paraligjorët realizojnë;
 - njohuritë dhe aftësitë që duhet të zotërojnë;
- ndryshimet e profesionit të paraligjorit me profesionet e tjera.

Roli i paraligjorit

Bazuar në legjislacionin në fuqi profesioni i paraligjorit nuk është një profesion i rregulluar me ligj, por nga eksperiencia e Centre for Legal Empowerment (CLE), vendeve të rajonit dhe jo vetëm, paraligjor do të konsiderojmë një profesionist që:

- ka njohuri të përgjithshme në fushën e drejtësisë, që ofron shërbime të ndihmës juridike parësore për çështje të thjeshta dhe orienton mbi të drejtat e qytetarëve dhe shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre;
- lidh marrëdhënien midis familjes/individit dhe avokatit për një problematikë ligjore dhe mban kontakte të vazhdueshme me familjen/individin, si dhe mbledh informacionin e nevojshëm që mund t'i shërbejë avokatit për ndjekjen e çështjes;
- ushtron punën e tij në terren, kanalizon dhe përcjell problematikat e hasura në komunitet pranë institucioneve shtetërore përgjegjëse;
- është urë lidhëse midis komunitetit dhe punës në zyrë;
- bën organizimin e komunitetit nëpërmjet njohurive ligjore që ai ka.

Mesazhi udhëheqës i punës së paraligjorit duhet të jetë “Ne do ta zgjidhim problemin bashkë”.

Detyrat e paraligjorit

Nga analizimi i legjislacionit në fuqi, punës në terren të ndjekur nga CLE dhe praktikave të ndjekura nga vendet e huaja, mund të parashtrijmë se detyrat e paraligjorit janë:

- ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor i komunitetit, duke synuar fuqizimin ligjor të tij;
- organizimi i komunitetit: ai bën të mundur transferimin e njohurive ligjore në komunitet dhe advokon për të zgjidhur problemet e tyre;
- këshillimi ligjor bazik duke përfshirë: hartimin e shkresave, përpilimin e dokumenteve për të vënë në lëvizje institucionet shtetërore përgjegjëse;

- shoqërimi para institucioneve shtetërore përgjegjëse dhe përfaqësimi i komunitetit pranë tyre;
- identifikimi i problematikave ligjore dhe çështje që prekin komunitetin ku vepron;
- referimi i rasteve pranë ofruesve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore;
- informimi mbi ndihmën juridike, mekanizmat e saj, kriteret për të përfituar dhe institucionet shtetërore përgjegjëse për ofrimin e saj;
- identifikimi i problematikave ligjore që pengojnë aksesin e komunitetin në ndihmën juridike;
- dhënia e informacionit mbi zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve dhe prirja për aftësi bashkëpunuese me autoritetet vendore, qendrore dhe të pavarura.


Aftësitë e nevojshme për rolin e paraligjorit

Duke marr në konsideratë faktin se paraligjori e zhvillon punën e tij me komunitetin, përveç njohurive profesionale që ai duhet të gëzojë dhe aftësi të tjera në aspektin social, psikologjik dhe njerëzor, si:

- njohja e karakteristikave të komunitetit, ku ai vepron, qofshin këto karakteristikat sociale, ekonomike, kulturore, psikologjike, financiare etj.;
- dëshira për të punuar dhe ndërvepruar me komunitetin;
- aftësi drejtuese ose potencial për t'u bërë udhëheqës në komunitet
- aftësi të të menduarit kritik dhe për të evidentuar vërtetësinë e fakteve që i parashtrihen nga komuniteti;
- aftësi për të qenë një qytetar aktiv, e lidhur ngushtë kjo me ndjeshmërinë ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut;
- aftësi për të folur në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, për të qenë dhe për t'u ndjerë sa më pranë komunitetit;
- të qenit empatikë, në mënyrë të tillë që të fitojmë besueshmërinë e komunitetit;
- të qenit nxitës në momente të vështira, për të mos lejuar që komunitetit të dorëzohet në kuadër të ndjekjes së problematikës.

Paraligjori është asistenti ligjor, aktivisti apo ofruesi i shërbimit të ndihmës juridike parësore?

Profesioni i paraligjorit ndryshon nga profesioni i asistentit ligjor, aktivistit apo ofruesit të shërbimit të ndihmës juridike parësore:



IV. Puna e paraligjorit

Paraligjori duhet të jetë një njohës i mirë i legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, në mënyrë të tillë, që të identifikojë në kohë të shpejtë rastet që mund të jenë përfitues të saj. Detyra e paraligjorit në punën e tij të përditshme qëndron në evidentimin e:

- Çështjes së parashtruar nga komuniteti;
- Përfituesve të ndihmës juridike;
- Kriterëve ligjore për të qenë përfitues;
- Dokumentacionit të nevojshëm, si dhe procedurat që duhet të ndiqen për përfitimin e ndihmës juridike dytësore;
- Përjashtimit nga taksat dhe tarifat gjyqësore.

IV.1 Përfituesit e ndihmës juridike

Paraligjori pasi ka identifikuar problematikën që duhet të ndjek, duhet të analizojë nëse individi/familja që parashtron problematikën plotëson kriteret për të qenë përfitues i ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Përfituesit e ndihmës juridike të garantuar nga shteti janë:

- shtetasit shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- shtetasit e huaj ose personat pa shtetësi, të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;
- shtetasit e huaj, ose personat pa shtetësi, që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;
- azilkërkuarit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

IV.2 Kriteret ligjore për të qenë përfitues

Shtetasit e sipërpërmendur janë përfitues të ndihmës juridike të garantuar nga shteti nëse plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara nga ligji nr.111/2017 dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ligji nr.111/2017 i ka ndarë përfituesit e ndihmës juridike të garantuar nga shteti në dy kategori:

- personat që duhet të plotësojnë kriteret ligjore për të qenë përfitues të saj **dhe**
- kategoritë e veçanta që e përfitojnë atë pavarësisht kriterëve.

Kriteret ligjore që duhen vlerësuar për të identifikuar një përfitues të ndihmës juridike të garantuar nga shteti janë:

- pamundësia ekonomike; dhe
- pasuria e pamjaftueshme.

Kategoritë e veçanta janë kategoritë, që e përfitojnë ndihmën juridike të garantuar nga shteti pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre, si:

- viktimat e dhunës në familje;
- viktimat e abuzuara seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- personat, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore; personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- personat, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- personat, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- personat, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Pamundësia Ekonomike

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përgatitje të dokumentacionit për ndjekje të çështjeve në institucionet shtetërore përgjegjëse, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile. Pamundësia ekonomike nënkupton kur:

- Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve

të familjes, janë më të ulëta se 50% e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi;

- Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi;
- Nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Me të ardhura, ligji nr.111/2017 ka nënkuptuar të ardhurat mujore që sigurohen nga pagat, veprimtaria ekonomike, interesat e depozitave bankare, të ardhurat nga pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen:

- ndihma ekonomike;
- pensioni social;
- pagesat e papunësisë;
- përfitimet e invalidëve (sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës);
- pagesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara;
- rimbursimi i shpenzimeve për energji;
- rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë;
- paketa higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara.

Në lidhje me pagën minimale, ajo është e përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 113, datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”⁵ dhe që prej muajit Prill 2023 është 40 000 (dyzetë mijë).

Pasuria e pamjaftueshme

Pasuria e pamjaftueshme nënkupton se personi nuk duhet të ketë në pronësi të tij, pasuri që tejkalojnë vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi. Pasuria, në kuptim të ligjit nr.111/2017, është pasuria e çdo lloji, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe të drejtat reale pasurore. Sipas përcaktimeve të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë janë pasuri të paluajtshme toka, burimet e rrjedhjet e ujërave, drurët, ndërtesat, ndërtimet e tjera notuese të lidhura me tokën dhe çdo gjë që është e trupëzuar në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me tokën ose ndërtesën. Të gjitha sendet e tjera, që nuk përfshihen në pasuritë e paluajtshme, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme.

Pasuria e paluajtshme e përdorur nga pronari ose bashkëpronari, si banesë e tij parësore për jetesën familjare dhe sendet e përjashtuara nga sekuestrimi, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, nuk konsiderohen pasuri, sipas kuptimit të këtij ligji. Referuar nenit 529 të Kodit të

⁵ Kujdes, verifikoni gjithmonë vendimin e Këshillit të Ministrave për miratimin e pagës minimale!

Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debitorit dhe nuk konsiderohen si pasuri në përputhje me ligjin nr.111/2017:

- sendet e përdorimit personal të debitorit dhe të familjes së tij, si: veshjet, shtresat, mbulesat, mobiliet për aq sa ato janë të nevojshme për jetesën e tyre;
- ushqimet dhe lëndët djegëse që i nevojiten debitorit dhe familjes së tij për tre muaj;
- dekoratat dhe sende kujtimi, letra, shkresa të familjes dhe librat profesionalë;
- librat, veglat muzikore, mjetet e artit që nevojiten për veprimtarinë shkencore dhe artistike të debitorit dhe të familjes së tij;
- deri 3 dynmë tokë, 2 kafshë për punimin e tokës, 1 lopë, 6 dele ose 6 dhi, fara për mbjelljen e ardhshme, si dhe ushqimi i këtyre kafshëve për 3 muaj për personat që jetojnë me punë bujqësore ose blegtorale;
- ndihma që u jepet nënave me shumë fëmijë ose të vetme, pensionet e pleqërisë, të invaliditetit ose familjarë ose bursa e studimit përveç kur detyrimi është për ushqim. Në këtë rast nuk mund të sekuestrohet më shumë se 1/2 e shumës së pensionit ose të bursës;
- frutat natyrore një muaj para se ato të piqen;
- sendet e nevojshme të punës për sigurimin e jetesës.

IV.3 Dokumentacioni i nevojshëm, si dhe procedurat që duhet të ndiqen për përfitimin e ndihmës juridike dytësore

Paraligjori pasi ka evidentuar çështjen dhe ka identifikuar përfituesit e plotësimin e kriterëve ligjore nga ana e tyre, duhet të fokusohet në plotësimin e dokumentacionit ligjor për përfitimin e ndihmës juridike. Ai duhet të arrij të identifikoj nëse çështja e evidentuar mund të trajtohet nëpërmjet ndihmës juridike dytësore dhe të ndihmojë individin/familjen në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Dokumentacioni i nevojshëm për t'u plotësuar në varësi të çështjes do të jetë:

- Formulari i kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike dytësore;
- Formulari e vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë;
- Formulari i vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta.

Në varësi të rastit⁶:

- Certifikatë familjare
- Vërtetim papunësie;
- Vërtetim që trajtohesh me ndihmë ekonomike;
- Vërtetim që trajtohesh me pagesën e aftësisë së kufizuar (paaftësi mendore/fizike);
- Vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme që disponon;
- Vërtetim page bruto dhe neto;

⁶ Ju lutemi jepini përparësi gjenerimit të dokumentacionit nëpërmjet e-Albania.

- Vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës, që kryhet prej këtyre institucioneve sikurse mund të jetë pensioni i pleqërisë.

Depozitimi i dokumentacionit, në varësi të çështjes, do të bëhet pranë gjykatave apo prokurorive kompetente:

- Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar (kërkuesi) personalisht ose nëpërmjet postës, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor. Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, mund ta paraqesë kërkesën nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë⁷. Kjo kërkesë është e përjashtuar nga tarifat dhe kostot gjyqësore.
- Në rast se kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet nga i pandehuri, organi procedues, që fillon hetimet shqyrton menjëherë, nëse përmbushen kriteret ligjore për përfitimin e ndihmës juridike nga i pandehuri. Nëse organi procedues, që fillon hetimet vlerëson se kriteret ligjore janë përmbushur, cakton menjëherë një avokat mbrojtës nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe njofton menjëherë të pandehurin, të cilit i ofrohet ndihmë juridike dytësore, si dhe avokatin e caktuar mbrojtës.

Në rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e ndihmës juridike dytësore, gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës shtetërore që e disponojnë atë. Në këto raste kërkesa për ndihmë juridike dytësore quhet e paraqitur në përfundimin e afatit të vendosur nga gjykata për paraqitjen e dokumentacionit plotësues nga organet e administratës shtetërore. Fakti që kërkuesi nuk përdor formularët, por jep të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të shqyrtuar kërkesën e tij, aplikimi i tij për ndihmë juridike dytësore nuk mund të mos pranohet.

Pranimi i kërkesës për përfitimin e ndihmës juridike dytësore

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për të përfituar nga ndihma juridike dytësore, gjykata mund të vendosi pranimin ose rrëzimin e kërkesës. Ky vendim jepet i arsyetuar dhe i njoftohet kërkuesit dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas⁸:

- brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;
- gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;

⁷ **Kujdes, fakti që personi depoziton kërkesën në gjykatën jo kompetente nuk është arsye për të rrëzuar kërkesën (transferohet kërkesa në gjykatën kompetente sipas KPC).**

⁸ <https://ndihmajuridike.gov.al/>

- sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore:

- Pas njoftimit të vendimit, Dhoma Vendore e Avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit⁹. Dhoma Vendore e Avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, avokatit të caktuar dhe kërkuesit, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore.
- Avokati i caktuar, menjëherë, hyn në marrëdhënie me personin, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe fillon dhënien e shërbimeve të kërkuara. Avokati i caktuar zëvendësohet nga një avokat tjetër, nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, vetëm në rast se konstatohet një konflikt interesi midis avokatit dhe personit, të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore. Vendimi për zëvendësimin e avokatit të caktuar nga një avokat tjetër nga lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore merret nga: a) organi procedues, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar nga ky organ; b) Dhoma Vendore e Avokatisë, në rast se avokati që do të zëvendësohet është caktuar prej saj.

Pagesa e avokatit të caktuar, sipas procedurave të sipërpërmendura, do të kryhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.111/2017, akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe udhëzimit të Përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 18, datë 5.8.2020 “Për miratimin e kriterëve për marrjen e pagesave dhe tarifave të shpërblimit për avokatët që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”.

Rrëzimi i kërkesës për përfitim të ndihmës juridike dytësore

Në rast se gjykata vendos për rrëzimin e kërkesës, kërkuesi mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.

IV.4 Përjashtim nga taksat dhe tarifat gjyqësore

Personat të cilët kanë përfitur ndihmë juridike dytësore, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

- pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;

⁹ Procedura e rotacionit përcaktohet në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës së Avokatëve të Shqipërisë nr. 17/2020.

- pagimi i shpenzimeve gjyqësore, si: shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit pranë shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

Formulari i kërkesës për përjashtimin nga taksat dhe tarifat gjyqësore depozitohet në gjykatën që shqyrton çështjen në themel.

V. Paraligjori së shpejti një profesion i rregulluar

Paraligjori është një profesion i parregulluar në Republikën e Shqipërisë, edhe pse shumë persona kanë filluar ta ushtrojnë atë. Paraligjorët duhet të fillojnë dhe të vënë në lëvizje institucionet shtetërore përgjegjëse për të ndërmarr procedurat e nevojshme për rregullimin e këtij profesioni, duke ndërmarrë iniciativa që i drejtohen institucioneve shtetërore përgjegjëse për realizimin e tyre. Këto procedura do të përfshijnë:

- Ligji nr.111/2017 nuk e ka të parashikuar paraligjorin ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike. Nevojitet ndërmarrja e propozimeve për ndryshimin e ligjit nr. 111/2017, me qëllim përfshirjen e paraligjorit në skemën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe mbështetjen financiare të tyre me fondet e buxhetit të shtetit.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” (i ndryshuar), nuk e ka të parashikuar “Paraligjorin” në Listën Kombëtare të Profesioneve. Nevojitet ndërmarrja e propozimeve për ndryshimin e vendimit të sipërpërmendur, me qëllim shtimin e profesionit të paraligjorit në grupin njësi 3412 “Asistentë, specialist të punës sociale”.
- Ngritja e mekanizmave për zhvillimin e trajnimeve të detyrueshme në kuadër të rritjes së kapaciteteve të paraligjorëve, përpos ndjekjes së trajnimeve të vazhdueshme dhe specializimeve nga organizatat jofitimprurëse të shoqërisë civile që veprojnë në Shqipëri dhe jashtë saj apo Universitetet.
- Vendosja e të paktën 1 (një) paraligjori në çdo bashki, i cili do të qëndrojë në kontakt në bashki me strukturat komunitare të krijuara në qytet, si ndërlidhësi dhe këshilli komunitar dhe strukturat komunitare në fshat, si kryetari i fshatit dhe kryesia e fshatit. Strukturat komunitare në bashki janë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetin dhe në këtë mënyrë paraligjorët do të jenë më pranë komunitetit dhe problematikave të tyre.

LEGJISLACIONI

Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

VKM Nr. 55, datë 6.2.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”;

VKM Nr. 110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”;

Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor” (i ndryshuar);

Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 2, datë 25.03.2019 “Për procedurat, periodicitetin dhe rregullat për verifikimin e rrethanave për kthimin e përfitimeve”;

Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6, datë 20.08.2019 “Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtim në rastin e dhënies së ndihmës juridike”;

Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”;

Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 17, datë 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”;

Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18, datë 05.08.2020 “Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore”;

Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë nr.21, datë 25.03.2021 “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”;

Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë nr. 226, datë 25.03.2019 “Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”;

Urdhri i Ministrisë së Drejtësisë nr.531, datë 25.11.2019 “Për miratimin e kritereve dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të Shërbimeve të Ndihmës Juridike”.

ANEKSI NR.1
FORMULARËT E APLIKIMIT



FORMULAR APLIKIMI PER PERFITIMIN E NDIHMES JURIDIKE DYTESORE

Rrezervuar për institucionin/organizaten ku paraqitet kërkesa / te mos plotësohet nga aplikanti

Gjykata :
Referenca:
Numer protokolli:
Qyteti:

RUBRIKA 1: TE DHENAT E APLIKANTIT:

- a) **Emer -Atesi - Mbiemer:**
- b) **Datelindja:** **Vendlindja:**
- c) **Gjendja civile (i/e martuar-i/e ve-beqar-divorcuar):**
- d) **Shtetesia:**
- e) **Qëndrimi ne Shqiperi (me leje qëndrimi- i perkohshem):**
① Nese nuk ka shtetesi shqiptare.
- f) **Vendbanimi (Adresa) :**
(Kodi postar/Qyteti/Shteti):
- g) **Adresa për korrespondence: (nëse është e ndryshme nga me siper):**.....
.....
- h) **Kontaktet:**
- **Telefon:**
- **Email:**

TE DHENAT E PERFAQESUESIT TE APLIKANTIT (nese aplikimi nuk kryhet personalisht):


- a) **Emer -Atesi - Mbiemer:**
- b) **Adresa për korrespondence: (nëse është e ndryshme nga me siper):**.....
- c) **Kontaktet:**
- **Telefon:**
- **Email:**

RUBRIKA 2: CILESIA E PERFITUESIT TE NDIHMES JURIDIKE DYTESORE

2.1. A beni pjese ne nje prej kategorive te vecanta te pefituesve te ndihmes juridike?

Po Jo


Nese po, citoni kategorine:

 (ploteso dhe bashkelidh Formularin e Vetedeklarimit per Kategorite e Vecanta).

2.2. A beni pjese te perfituesit per shkak te te ardhurave dhe pasurive te pamjaftueshme?

Po Jo

Nese po, deklaroni te ardhurat dhe pasurite tuaja:

 (ploteso dhe bashkelidh Formularin e Vetedeklarimit te te Ardhurave dhe Pasurive).

2.2.1 Per aplikantin qe jeton vetem:

- Te ardhurat e mia jane nen vleren e pages minimale mujore te percaktuar me ligj.
- Pasurite e mia jane nen vleren e 36 pagave minimale mujore te percaktuar me ligj.

2.2.2 Per aplikantin qe jeton ne nje familje:

- Te ardhurat e familjes jane me te uleta se 50% e pages minimale mujore te percaktuar me ligj.
- Pasurite e familjes jane nen vleren e 36 pagave minimale mujore te percaktuar me ligj.

RUBRIKA 3: PSE PO APLIKOJ PER NDIHME JURIDIKE DYTESORE?

Kjo kerkese per ndihme juridike, paraqitet:

3.1. **PARA FILLIMIT TE PROCESIT GJYQESOR**

3.1.1. Ne kete faze, Ndhma Juridike Dytesore, ju duhet per:

1. Keshillim lidhur me zgjidhjen gjyqesisht te problemit?
2. Pergatitjen dhe paraqitjen e nje kerkese, kerkese padie / deklarates se mbrojtjes ndaj paditesit?

<input type="checkbox"/>
<input type="checkbox"/>

3.1.2 LLoji i ceshtjes per te cilen kerkoni Ndhme Juridike Paresore:

Civile Penale Administrative

3.1.3 Ju lutem jepni te dhena rreth ceshtjes per te cilen kerkoni sherbime ligjore:

Fokusohuni vecanerisht:

- *Cfare ka ndodhur?*
- *Cilat jane palet/personat e perfshire ne konflikt me ju?*
- *Rrethana plotesuese me rendesi per ceshtjen?*

.....

.....

.....

.....

.....

.....


.....

.....

.....

.....

.....

 - Nese hapësira e mesiperme nuk mjafton, ju lutem vijoni ne faqen ne fund te ketij formulari.

3.2. **SE BASHKU ME KERKESE PADINE**

3.2.1. Ne kete faze, Ndhima Juridike Dytesore, ju duhet per:

1. Keshillim lidhur me zgjidhjen gjyqesisht te problemit?
2. Pergatitjen e akteve te mbrojtjes dhe dokumentacionit provues per gjykatën?
3. Perfaqesimin gjate shqyrtimit gjyqesor?

3.2.2 LLoji i ceshtjes per te cilen kerkoni Ndhime Juridike Paresore:

Civile Penale Administrative Familjare

3.2.3 A keni angazhuar nje avokat per ofrimin e sherbimeve ligjore lidhur me ceshtjen?

Po Jo

3.2.4 Ju lutem jepni te dhena rreth bazueshmerise se kerkeses suaj:

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....



- Nese hapësira e mesiperme nuk mjafton, ju lutem vijoni ne faqen ne fund te ketij formulari.

3.3. **GJATE SHQYRTIMIT GJYQESOR** (perpara perfundimit te hetimit gjyqesor)

3.3.1 LLoji i ceshtjes per te cilen kerkoni Ndhime Juridike Paresore:

Civile Penale Administrative Familjare

3.3.2 Ne kete proces ju jeni ne cilesine e:

- Paditesit
- Te paditurit
- Person i trete
- Nuk e di

3.3.3. Ne kete faze, Ndhima Juridike Dytesore, ju duhet per:

1. Keshillim lidhur me vijimin e shqyrtimit gjyqesor?
2. Pergatitjen e akteve te mbrojtjes dhe dokumentacionit provues per gjykatën?
3. Perfaqesimin gjate shqyrtimit gjyqesor?

3.3.4 A keni angazhuar nje avokat per ofrimin e sherbimeve ligjore lidhur me ceshtjen?

Po Jo

3.3.5 Ju lutem jepni te dhena rreth bazueshmerise se kerkeses suaj:

.....
.....
.....
.....
.....
.....



- Nese hapësira e mesiperme nuk mjafton, ju lutem vijoni ne faqen ne fund te ketij formulari.

RUBRIKA 4: DEKLARIME

① *Ju lutem lexoni me vemendje perpara se te nenshkruani!*

1. Deklaroj se i gjithë informacioni që kam vene në dispozicion, përmes këtij aplikimi, është i vertetë dhe i saktë. Jam i informuar se përben shkelje në kuptim të Nenit 32 të Ligjit Nr.111/2017 dhe të legjislacionit penal të Republikës së Shqipërisë:
 - Dhenia e një informacioni/deklarimi të pasakte/ të pavertete;
 - Dhenia e dokumentave false;
2. Deklaroj dhe pranoj se, nëse vertetohet pasaktësia / falsiteti i një informacioni dhe/ose një dokumenti, ndaj meje mund të ndermerren masat e nevojshme të përgjegjësisë për çdo kosto të shkaktuar si rezultat i përfitimit pa të drejtë të ndihmës juridike për shkak të pasaktësisë/pavertetësisë apo falsitetit të provuar. Konkretisht, përmes këtij deklarimi, pranoj se në rast pasaktësie dhe/ose falsiteti të një informacioni ose dokumenti, do jem i detyruar të rimburoj shpenzimet për avokatin që ka ofruar ndihmën juridike si dhe çdo shpenzim apo kosto tjetër që do të rezultojnë nga përfitimi pa të drejtë i ndihmës juridike falas.
3. Deklaroj dhe pranoj se të gjitha të dhënat e vena në dispozicion nga unë, mund të verifikohen për efekt të saktësisë, vertetësisë dhe efektshmërisë së tyre lidhur me aplikimin tim dhe se ky deklaram mund të shërbejë si autorizim për qendrën/klinikën për të ndermarre çdo veprim me qëllim verifikimin e të dhënave të këtij formulari.
4. Deklaroj dhe pranoj se në vijim do të informoj mbi çdo informacion shtesë që do të ndryshojë statusin tim si përfitues i ndihmës juridike falas.

RUBRIKA 5: DOKUMENTACIONI SHOQERUES

Ky aplikim shoqerohet nga dokumentat si më poshtë:

A. Dokumenta Identifikimi të Aplikantit;

.....;
.....;
.....;
.....;

B. Dokumenti i autorizimit për përfaqësuesin e Aplikantit;

C. Formulari i Vetedeklarimit për Kategoritë e Vecanta (shoqeruar me dokumentat bashkelidhur); dhe/ose Formulari i Vetedeklarimit të të Ardhurave dhe Pasurive (shoqeruar me dokumentat bashkelidhur);

D. Dokumenta të tjera:

.....;
.....;
.....;
.....;

Nenshkrimi i Aplikantit

Nenshkrimi i punonjësit të klinikes/qendres:

Z/Znj. _____
(emer-mbiemer-nenshkrim)

Z/Znj. _____
(emer-mbiemer-nenshkrim)

Ne _____
(qyteti)

Date: ____ . ____ . 20__

① Informacioni si më sipër, do të trajtohet në përputhje me Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe çdo disponim i këtyre të dhënave do të kryhet në përputhje me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.



**ANKIM
KUNDER VENDIMIT TE GJYKATES
PER RREZIMIN E KERKESES
PER NDIHME JURIDIKE DYTESORE**

Rrezervuar për institucionin/organizaten ku paraqitet kërkesa / te mos plotësohet nga aplikanti

Gjykata :

Referenca:

Numer protokolli:

Qyteti:

RUBRIKA 1: TE DHENAT E ANKUESIT:

a) **Emer -Atesi - Mbiemer:**

b) **Datelindja:** **Vendlindja:**

c) **Gjendja civile (i/e martuar-i/e ve-beqar-divorcuar):**

d) **Shtetesia:**

e) **Qëndrimi ne Shqiperi (me leje qëndrimi- i perkohshem):**

① Nese nuk ka shtetesi shqiptare.

f) **Vendbanimi (Adresa) :**

(Kodi postar/Qyteti/Shteti):

g) **Adresa për korrespondence: (nëse është e ndryshme nga me siper):**

h) **Kontaktet:**

– **Telefon:**

– **Email:**

TE DHENAT E PERFAQESUESIT TE ANKUESIT (nese ankimi nuk kryhet personalisht):

a) **Emer -Atesi - Mbiemer:**

b) **Adresa për korrespondence: (nëse është e ndryshme nga me siper):**

c) **Kontaktet:**

– **Telefon:**

– **Email:**

RUBRIKA 2: VENDIMI KUNDER TE CILIT DEPOZITOHET ANKIMI

2.1. Te dhenat e vendimit qe kundershohet:

Vendimi Nr. _____ ;
Date _____ ;
Gjykata _____ ;

2.2. Lidhur me kerkesen, gjykata ka vendosur (cito nga dispozitivi i vendimit):

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

RUBRIKA 3: SHKAQET LIGJORE TE ANKIMIT KUNDER VENDIMIT PER RREZIMIN E KERKESES PER NDIHME JURIDIKE DYTESORE

3.1. Plotesohen kushtet e perfitimit te Ndhimes Juridike Dytesore (Sipas neneve 11 dhe 12 te Ligjit 111/2017):

Konkretisht: Ankuesi ka kerkuar te perfitoje Ndhime Juridike Dytesore ne cilesine e:

- personit qe ben pjese ne nje prej kategorive te vecanta te pefituesve te ndihmes juridike

Po Jo

Nese _____ po, _____ citoni _____ kategorine: _____

Dhe/ose

- personit me te ardhura dhe pasuri te pamjaftueshme

Po Jo

3.1.2 Vendimi i rrezimit te kerkeses eshte i pambeshtetur ne prova dhe ne ligj, per sa me poshte:

① (Duhet kundershuar shkaqet e rrezimit te kerkeses, referuar arsyetimit te vendimit nga gjykata)

.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....
.....

ANEKSI NR.2

TARIFAT PËR AVOKATËT

Lloj i shërbimit	Tarifa në Lekë
I. Mbrojtja juridike në fushën penale	
<u>Përfaqësimi në çështjet penale</u>	
Shërbim për ndalimet dhe arrestimet deri në dhënien dhe ndryshimin e masës së sigurimit	15,000
<u>Ndihmë juridike për hetimet paraprake deri në dërgimin e çështjes për gjykim</u>	
= Për kundërvajtjet penale	20,000
= Për krimet që parashikojnë një dënim deri në 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	50,000
= Për krimet që parashikojnë një dënim mbi 10 vjet burgim dhe në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	60,000
<u>Ndihmë juridike për gjykimet në shkallë të parë</u>	
= Për kundërvajtjet penale	20,000
= Për krimet që parashikojnë një dënim deri në 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	30,000
= Për krimet që parashikojnë një dënim mbi 10 vjet burgim, në gjykatën e Rr. Gjyqësor	80,000
=Për krimet që gjykohen në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	96,000
<u>Ndihmë juridike për gjykimet në Gjykatat e Apelit dhe ajo e Lartë, Kushtetuese</u>	
= Për gjykimet nga Gjykatat e Apelit	40,000
= Për gjykimet në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese	50,000
<u>II. MBROJTJA JURIDIKE NË FUSHËN CIVILE DHE ADMINISTRATIVE</u>	
<u>Përfaqësimi në shkallë të parë</u>	
= Përfaqësimi në shkallë të parë, pa palë	15,000
= Përfaqësimi në shkallë të parë, me palë	40,000
<u>Përfaqësimi në Gjykatën e Apelit, atë të Lartë dhe Kushtetuese</u>	
= përfaqësimi në Gjykatën e Apelit	45,000
= përfaqësimi në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese	60,000
<u>Shërbime juridike jashtëgjyqësore</u>	

= Përgatitje kërkesë ankimore	15,000
= Përgatitje Rekursi për në Gjykatën e Lartë si dhe kërkesë në Gjykatën Kushtetuese	25,000
= Ofrim ndihmë juridike në formë këshillimi	500-1500 lek/ora
II. <u>TË TJERA SHËRBIME AVOKATIE</u>	
Të tjera shërbime avokatie që mund të mos jenë të përfshirë në zërat e mësipërm	

info@cle.al

www.cle.al

Centre for Legal Empowerment



centre_for_legal_empowerment

CLE–Centre for Legal Empowerment